

VENDIM
Nr.815, datë 15.12.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.434, DATË 28.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FONDIN E VEÇANTË NË INSTITUCIONET BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4 e vendimit nr.434, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Përjashtimisht për vitin 2006, masa e shpërblimit e çdo punonjësi këtë fund viti të jetë deri 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i veçantë, i miratuar për vitin 2006.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI